UDHËZIM
Nr. 43, datë 15.10.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 37, DATË 5.10.2015, "PËR PROCEDURËN E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË, TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË, SI DHE PËR TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË PROGRAMET E STUDIMIT TË OFRUARA NGA KËTO INSTITUCIONE, PËR VITIN AKADEMIK 2015–2016"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 5, të nenit 33, të pikës 1, të nenit 34, dhe të nenit 35, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 37, datë 5.10.2015, "Për procedurën e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, të ofruara nga institucionet private të arsimit të lartë, si dhe për transferimin e studimeve në programet e studimit të ofruara nga këto institucione, për vitin akademik 2015–2016", në fund të pikës 21 të shtohet përcaktimi si më poshtë:

"Bëjnë përjashtim nga përcaktimi i mësipërm vetëm programet e përbashkëta, të ofruara në bashkëpunim me IAL të huaja. IAL-ja private, që ofron programin e përbashkët, veç përcaktimeve në marrëveshjen mes palëve për programin përkatës të studimit, mund të përcaktojë dhe kritere të tjera shtesë sipas parashikimeve në aktet e saj të brendshme.".

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si edhe institucionet private të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla